



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Data: 3.4.2023

Nr: 251

Ora: 16:00

VENDIM

PËR

**SHQYRTIMIN E KËRKESËS PËR MIRATIMIN E LISTËS SHUMEMËRORE TË KËSHILLIT BASHKIAK,
BASHKIA TIRANË, TË SUBJEKTIT ZGJEDHOR "FRONTI I MAJTË", PËR ZGJEDHJET PËR
ORGANET E QEVERISJES VENDORE TË DATËS 14 MAJ 2023**

Sot, më datë 3.4.2023, unë Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, pasi shqyrtova kërkesën e:

KËRKUES: Partia "Fronti i Majtë", me shkronja nistore "FM"

OBJEKTI: Miratimi i listës shumëmeore të këshillit bashkiak, Bashkia Tiranë, të subjektit zgjedhor "Fronti i Majtë", për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023.

BAZA LIGJORE: Nenet 19, pikat 1, shkronja "n" e 2, 70 dhe 73, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, të udhëzimit nr. 1, datë 18.1.2023 "Për përcaktimin e rregullave për depozitimin dhe verifikimin e dokumentacionit të kandidimit, afatet për publikimin e listave të kandidatëve dhe miratimin e modeleve të kandidimit për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore"

V Ë R E J:

Presidenti i Republikës, me dekretin nr. 13864, datë 24.10.2022, ka caktuar datën 14 maj 2023, si datën e zhvillimit të zgjedhjeve për organet e qeverisjes vendore.

Data: 3.4.2023 Nr: 251
Ora: 16:00



"Për shqyrtimin e kërkesës për miratimin e listës shumëmeore të këshillit bashkiak, Bashkia Tiranë, të subjektit zgjedhor "Fronti i Majtë", për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023"

Partia “Fronti i Majtë”, me vendimin nr. 143, datë 8.3.2023, të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, është regjistruar si subjekt zgjedhor për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023.

Në mbështetje të neneve 67 e 72, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë” të ndryshuar, subjekti zgjedhor “Fronti i Majtë” ka paraqitur në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve dokumentacionin për miratimin e listës shumëmemërore të kandidatëve për anëtarë të këshillit bashkiak, Bashkia Tiranë.

Në bazë të nenit 73 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, administrata e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve verifikoi listat shumëmemërore të kandidatëve për anëtarë të këshillit bashkiak të subjektit zgjedhor “Fronti i Majtë” dhe dokumentacionin bashkëngjitur të paraqitur. Në përfundim të procesit të verifikimit paraprak u konstatuan mangësi dhe mospërbushje të dokumentacionit si më poshtë:

- U konstatua se kërkesa për regjistrimin e listës shumëmemërore të kandidatëve për anëtarë të këshillit bashkiak, Bashkia Tiranë, nuk respekton kuotën gjinore sipas pikës 6, të nenit 67 të Kodit Zgjedhor.
- U konstatua se lista shumëmemërore e kandidatëve për anëtarë të këshillit bashkiak, Bashkia Tiranë, mbyllet me numrin rendor 32 (tridhjetë e dy). Kjo listë nuk është në përputhje me pikën 4, të nenit 67 të Kodit Zgjedhor, duke mos plotësuar numrin e kandidatëve në listën shumëmemërore të përcaktuar nga Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, në vendimin nr. 100, datë 8.3.2023 “Për caktimin e numrit të kandidatëve në listat shumëmemërore të paraqitura nga subjektet zgjedhore për çdo zonë zgjedhore, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023”, i ndryshuar. Në referim të sa më sipër, lista shumëmemërore duhet të ketë 62 (gjashtëdhjetë e dy) kandidatë.
- Konstatohet se disa prej emrave të listës shumëmemërore të kandidatëve për anëtarë të këshillit bashkiak, Bashkia Tiranë, figurojnë në listat shumëmemërore të një partie tjetër.

Në zbatim të nenit 73, pika 1, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, dokumentacioni i depozituar ju kthye për korrigjim subjektit zgjedhor “Fronti i Majtë”.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, me vendimin nr. 219, datë 30.03.2023, brenda afatit ligjor të parashikuar nga Kodi Zgjedhor, i ka dhënë mundësi subjektit zgjedhor Partisë “Fronti i Majtë”, për të plotësuar të metat e dokumentacionit brenda datës 31.03.2023. Nga verifikimi i kryer rezultoi se, subjekti zgjedhor “Fronti i Majtë” nuk i ka përmbushur detyrimet në lidhje me plotësimin e dokumentacionit.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenet 19, pikat 1, shkronja “n” e 2, 67, 72 dhe 73, pika 2 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar si dhe udhëzimin nr. 1, datë 18.1.2023 “Për përcaktimin e rregullave për depozitimin dhe verifikimin e dokumentacionit të kandidimit, afatet për publikimin e listave të kandidatëve dhe miratimin e modeleve të kandidimit për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore”,

V E N D O S:

1. Mosregjistrimin e listës shumemërore të kandidatëve për anëtarë të këshillit bashkiak, Bashkia Tiranë, të subjektit zgjedhor “Fronti i Majtë”, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen elektronike zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve, brenda 3 (tre) ditëve nga shpallja e tij.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Ilirjan CELIBASHI